URDHËR
Nr. 206, datë 6.5.2022

PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE NË SHPENDË, NË MJEDISET E HAPURA DHE NË TREGJET E KAFSHËVE TË GJALLA

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, të shkronjës "b", nenit 15, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e shitjes dhe tregtimit të shpendëve të gjallë në mjediset e hapura dhe tregjet e kafshëve të gjalla në bashkitë Shijak dhe Durrës.
2. Ndalimin e lëvizjes së shpendëve të gjallë nga ferma në fermë dhe nga ferma në tregjet e kafshëve të gjalla në bashkitë Shijak dhe Durrës.
3. Lejimin e lëvizjes së shpendëve të gjallë, vetëm për në thertore në bashkitë Shijak dhe Durrës, të shoqëruar me dokumentacionin e parashikuar sipas legjislacionit në fuqi.
4. Urdhri nr. 154/1, datë 29.4.2022, "Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së influencës aviare në shpendë, në mjediset e hapura dhe në tregjet e kafshëve të gjalla", shfuqizohet.
5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca